



Pranuar / Dorezuar Prinjenur / Predato Received / Delivety	16-04-2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTOK	1823/2021		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.223/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2346/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 15.03.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.432/2019 të datës 29.07.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: rruga "Idriz Gjilani", Dardani Nr. 507/ Hyrja 13 Komuna e Prishtinës, kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.432/2019 e datës 29.07.2019, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi vendimi Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, KOM/1107 i datës 25.07.2019

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 08.10.2014 i punësuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime

Logjistike në Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme", i pakënaqur me institucionin punëdhënës për shkak të mos realizimit të shtesave në pagë sipas vendimit nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 01.07.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me datë 25.07.2019 ka nxjerrë Vendimin me numër KOM/1107 me të cilën e ka shpallur vetën dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë jo kompetent për të shqyrtuar kërkesën e ankuesit të datës 01.07.2019, si dhe ka vendosur që kërkesën në fjalë do ta dërgojë me akt përcjellës në Ministrinë e Administratës Publike për shqyrtim.

Ankuesi kundër Vendimit të datës 25.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.07.2019 brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë me numër protokoli 3309/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 30.07.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Më datë 05.08.2019 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka dërguar përgjigjen në ankesë me dosjen e bashkangjitur të lëndës me 9 faqe.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 06.09.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 15.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2346/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 06.09.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 29.07.2019

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 30.07.2019 e parashtruar nga ankuesi me numër protokoli 3809/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KOM/1107 të Komisionit për

Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministri së Tregtisë dhe Industrisë të datës 25.07.2019; Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës së bashku me aneksin I; Raportin e Auditimit për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë të datës 31.12.2018; E-maili e datës 14.10.2014 dërguar nga [] për ankuesin; Procesverbalin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të ankesave të datës 08.07.2019; E-maili e datës 29.07.2019 dërguar nga ankuesi për [] Kërkesën e ankuesit të parashtruar në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të datës 01.07.2019; E-mailin e datës 17.12.2015 dërguar nga ankuesi për [] Kërkesën për shtesa në pagë të datës 16.06.2014; Kërkesën për shtesa në pagë drejtuar Komisionit për Shyrtrimin e Shtesave për Kushtet e Tregut të Punës me numër protokoli:1131 të datës 07.02.2019; E-mailin e datës 17.12.2015 dërguar nga ankuesi për [] me korrespondencën e bashkangjitur prej 4 (katër) faqesh; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit të datës 08.10.2014 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Çertifikatën e ankuesit të periudhës qershor 2016; Çertifikatën e ankuesit të periudhës prill 2017; Çertifikatën e ankuesit të periudhës shkurt 2016; Çertifikatën e ankuesit të e periudhës prill 2015; Çertifikatën e ankuesit të datës 25.05.2010; Çertifikatën e ankuesit të periudhës janar-maj 2013; Shkresën e aplikimit të studentit për regjistrim të studimeve Master me nr:4330; Vërtetimin e statusit të studentit në studime Master të datës 20.09.2011; Diplomë e datës 14.02.2010 me numër nr.536/10; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 30.07.2019; Përgjigja në kërkesë e datës 05.08.2019; Aktgjykimin A.nr.2346/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 15.03.2021; Njoftimin e datës 06.09.2019 me numër prot:4221/2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar kompetencat e tij dhe pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [] është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit [] i cili pretendon për njohje të plotë të shtesës së Teknologjisë Informative sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pagesës në mënyra retroaktive të shtesave në pagë dhe se Vendimi me numër:KOM/1107 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 25.07.2019 është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, po ashtu ka konstatuar se ankuesit me datë 07.02.2019 ka parashtruar kërkesë për pagesën e shtesave mbi pagën bazë të te Komisioni për shqyrtimin e shtesave për kushtet e tregut në kuadër të Ministrisë Administratës Publike, si dhe kërkesa është nënshkruar edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë i cili njëherit është edhe zyrtari më i lartë administrativ në kuadër të institucionit si dhe Udhëheqësi i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, e që nënkupton se të lartcekurit në parim janë pajtuar me kërkesën e ankuesit drejtuar Komisionit për shqyrtimin e shtesave për kushtet e tregut në kuadër të Ministrisë Administratës Publike, kërkesë kjo e cila nuk është trajtuar.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesave, ka konstatuar se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë respektivisht Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e

nxjerrjes së Vendimit KOM/1107 të datës 25.07.2019 me të cilën e kanë shpallur vetën jo kompetent duke deklaruar se kërkesën e ankuesit me akt përcjellës do ta dërgojnë për shqyrtim në Ministrinë e Administratës Publike, respektivisht në Komisionin për Shqyrtimin e Shtesave për Kushtet e Tregut.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitive dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumes stimuluese për postet e caktuara, se paku një herë në muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. *Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkritazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhëne edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, tani më është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatojë se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitive për të cilat

niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitive në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofroje Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërin e realizimit të shtesës dhe një analize që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitive përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Si dhe shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Tregtisë dhe Industrisë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër të Vendimit KOM/1107 të datës 25.007.2019, ka vepruar pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.223/2021, datë 16/04/2021

Elakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben Mehmeti

Kryetari i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

